



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT GJIROKASTËR**

Gjirokastër më: 20.02.2026

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NE KATEGORINE EKZEKUTIVE
(SPECIALIST)**

**Lloji i diplomës “Shkencat Shoqërore”
niveli minimal i diplomës: Bachelor ose të barazvlefshme me to në shkencat
shoqërore.**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, levizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. **Spektori i Kulturës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionin:**

- **1 (një) Specialist për protokollin dhe arkivën, Kategoria e Pagës IV-2.**

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e levizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së levizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (LËVIZJE PARALELE DHE PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	01 Mars 2026
Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL:	06 Mars 2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin e mësipër është:

Adresa: Rruga “Ismail Kadare”, Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

1. Kryen punën për evidentimin, ruajtjen fizike, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve në bazë të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivin" dhe Ligjin Nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror";
2. Përpunon dokumentet e regjistruara, duke i sistemuar sipas dosjeve dhe drejtorive përkatëse;
3. Regjistron korrespondencën zyrtare, e përpunon dhe e shpërndan atë;
4. Organizon punën për evidentimin, ruajtjen fizike, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve në bazë të ligjeve në fuqi;
5. Protokollon Vendimet e Këshillit dhe urdhrat e Kryetarit të Këshillit të Qarkut, si dhe praktikën shkresore nënshkruar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut apo persona të tjerë të autorizuar prej tij;
6. Vendos në dispozicion shkresat dhe dokumentet që kërkohen nga sektorët;
7. Protokollon dokumentet që hyjnë dhe dalin nga institucioni, si dhe dokumentet ndërmjet sektorëve;
8. Mbajtja e inventarit të plotë të dokumenteve në arkiv.
9. Menaxhimi dhe përdorimi i sigurt i vulës zyrtare të institucionit.

1 LËVIZJA PARALELE

10. Përgatitja e kopjeve të certifikuara të dokumenteve për qytetarë dhe institucione.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" apo "Shumë mirë";
- ç) Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

1. Te zoterojë diplome Universitare Master Shkencor/ Profesional/ Bachelor në shkencat shoqërore ose të barazvlefshme me to në shkencat shoqërore.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, dokumentat si më poshtë:
a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

a- <http://eëë.dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/219-udhezime-dokumenta>

b-Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

Adresa: Rruga "Ismail Kadare", Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, brenda datës 01.03.2026

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 02.03.2024 pas verifikimit paraprak të kandidatëve Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" të faqja zyrtare e internetit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë si dhe në stenden e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

do të njoftohen individualisht nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar;
2. Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë";
3. Kodi i Procedures Civile, i ndryshuar;
4. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë,
5. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
6. Njohuritë mbi Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivin"
7. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"
8. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
9. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën me 20 pike, 10 pike për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe 10 pike për çertifikimet pozitive. Totali i pikeve për këtë vlerësim është 40 pike.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;

Adresa: Rruga "Ismail Kadare", Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmerine e tyre per karrieren.

Totali i pikeve per kete vleresim eshte 60 pike.

Ne perfundimin te vleresimit perzgjidhet kandidati, i cili renditet i pari nder kandidatet qe kane mare te pakten 70 pike.

Me shume detaje ne lidhje me vleresimin me pike, metodologjine e shperndarjes se pikeve, menyren e llogaritjes se rezultatit perfundimtar i gjeni ne Udhezimin nr. 2 dt. 27.03.2015 te Departamentit te Administrates Publike "www.dap.gov.al"

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Gjirokastër do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në stenden e Këshillit të Qarkut si dhe te faqja zyrtare e internetit te Keshillit te Qarkut Gjirokaster.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive

Këtë Informacion do ta merrni pranë Këshillit të Qarkut, duke filluar nga data 02.03.2026

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 21, Kreut IV, të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar .

Kushtet qe duhet te plotesoje kandidati ne proceduren e pranimit ne sherbimin civil jane :

- a) Te jete shtetas shqiptare;
- b) Te kete zotesi per te vepruar ;
- c) Te zoteroje gjuhen shqipe , te shkruar dhe te folur ;
- d) Te jete ne kushte shendetsore qe lejojne te kyeje detyren teknike perkatese;
- e) Te mos jete i denuar me vendim te formes se prere per te kryerjen e nje krimi apo per kryerjen e nje kundravajtje penale me dashje;
- f) Ndaj tij te mos jete mare masa disiplinore e largimit nga sherbimi civil , qe nuk eshte shuar sipas ligjit 152/2013 "Per nepunesin civil " i ndryshuar .

Kandidati duhet te plotesoje kerkesat e posacme si vijon :

Adresa: Rruga "Ismail Kadare", Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

i Te zoterojë diplome Universitare Master Shkencor/ Profesional/ Bachelor në shkencat shoqërore ose të barazvlefshme me to në shkencat shoqërore.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://ee.dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore.
- h- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.

Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 06.03.2026 në adresën: Rruga "Ismail Kadare", Këshilli i Qarkut Gjirokastrë.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 09.03.2026 , Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" te faqja zyrtare e internetit te Këshillit të Qarkut Gjirokastrë si dhe në stenden e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutivesi dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, për shkaqet e moskualifikimit .

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

1. Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar;
2. Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë";
3. Kodi i Procedures Civile, i ndryshuar;
4. Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
5. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë

Adresa: Rruga "Ismail Kadare", Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com

6. Njohuritë mbi Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivin”
7. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”
8. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

9. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatesisht:

- a- deri në 60 pikë për vlerësimin me shkrim
- b- Intervisten e strukturuar me gojë që konstiton në motivimin , aspiratat dhe pritshmerine e tyre për karrieren , deri në 25 pike.
- c- Jetëshkrimin , që konstiton në vlerësimin e arsimimit të përvijes e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse, deri në 15 pike.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” të faqja zyrtare e internetit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë si dhe në stenden e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet.

Për sqarime të mëtejshme mund të na kontaktoni në adresën e e-mail keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com ose në adresën: Rruga “Ismail Kadare”, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë

KRYETAR
Dirio Selimi



Adresa: Rruga “Ismail Kadare”, Tel: +355842563721, email: keshilli.qarkutgjirokaster@yahoo.com